

GERMAN AND ALBANIAN PROVERBS IN THE INTERCULTURAL CONTEXT

Shadan RAMADANI¹

1 Department of German Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

Corresponding author e-mail: shadan.ramadani@unite.edu.mk

Abstract

Proverbs have an important role in the acquirement of German as a foreign language. The easiest way to present a cross-cultural comparison of proverbs is the onomasiological approach. In this study, I will attempt to show the names of animals as an element of indication of the similarities and differences between the German language and Albanian (Pferd/(kalë), Hund/(qen), Bär/(ari), etc.). The examples presented will clarify that in both languages there are characteristics and physical attributes of animals as well as their use by people that serve as a motive in the creation of proverbs.

Therefore, we often encounter similarities and differences. Moreover, we will start from the German proverbs that reveal even more the comparison between the German and Albanian languages, since identity and idiomatic transformation represent the arbitrary process of naming as well as their cultural similarities and differences. What is particularly interesting for a cross-cultural comparison are the idiomatically transformed Albanian equivalents of proverbs in the German language. In Albanian, when some idiomatic transformations of animal names are replaced, the other components vary.

Keywords: Proverbs, Cross-Cultural comparison, German as a foreign language.

Hyrje

Fjalët e urta luajnë një rol të rëndësishëm në përvetësimin e gjermanishtes si gjuhë e huaj. Mënyra më e lehtë për të paraqitur një krahasim ndërkulturor të fjalëve të urta është përqasja onomasiologjike. Në këtë studim së pari do të përpiqem të marr emrat e kafshëve (Pferd/(kalë), Hund/(qen), Bär/(ari) etj. si elemente për të vënë në pah dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet gjuhës gjermane dhe shqipe. Shembujt e shtruar do të qartësojnë se në të dyja gjuhët ekzistojnë veti karakteristike dhe fizike të kafshëve si dhe përdorimi i tyre nga njerëzit shërbejnë si motiv në krijimin e fjalëve të urta.

Prandaj shpesh hasim në ngjashmëri dhe dallime në të dyja gjuhët. Për më tepër, do të nisemi nga fjalët e urta gjermane që shpalosin edhe më qartë krahasimin ndërmjet gjuhës gjermane dhe shqipe, pasi që identiteti dhe transformimi idiomatik paraqesin procesin arbitrar të emërtimit si dhe ngjashmërive dhe dallimeve kulturore të tyre. Ajo që është veçanërisht interesante për një krahasim ndërkulturor janë ekuivalentet e gjuhës shqipe të transformuar në mënyrë idiomatike me fjalët e urta në gjuhën gjermane. Në shqip disa transformime idiomatike të emrave të kafshëve zëvendësohen, përndryshe përbërësit e tjerë variojnë.

1. Fjalët e urta në kontekstin ndërkulturor

Fjalët e urta në përgjithësi janë fjali të njohura, të formuara në mënyrë të qëndrueshme dhe të përherëshme, që përmbajnë një rregull të formuluar konciz të jetës dhe mençurisë respektivisht përvojës së përgjithshme të jetës apo të një populli të caktuar. Ashtu si argumenton edhe autori i njohur, Bünting, se: *Këto shprehje figurative përdoren në të folurën e përditshme, në komentet e folura dhe të shkruara dhe në tekstet e përditshme dhe letrare. Ato i bëjnë shprehjet tona dhe tekstet të gjalla dhe u japin deri diku edhe ngjyra artistike.* (Bünting, K. D. 1995, fq. 5).

Ato e zbukurojnë gjuhën tonë të përditshme dhe e pasurojnë atë nëpërmjet diversitetit gjuhësor. Prandaj luajnë një rol të rëndësishëm veçanërisht në përvetësimin e gjermanishtes si gjuhë e huaj. Është e pakontestueshme se ndërmjetësimi i gjuhës nënkupton edhe ndërmjetësimin e kulturës, pasi që të mësuarit e një gjuhe gjithmonë hap njëkohësisht horizontin ndaj një bote të re, vlerave dhe koncepteve të tjera si dhe qëndrimeve dhe sjelljeve tjera. Etimologjia e fjalëve të urta të një gjuhe përkatëse qëndron në një lidhshmëri të ngushtë me historinë kulturore dhe folklorin e folësve të po asaj gjuhe.

Shumë fjalë të urta e kanë origjinën në kohërat e lashta dhe këtë e shpjegojnë më së miri autorët Annelies dhe Horst Beyer: *Çdo fjalë e urtë është një foshnjë e kohës së saj, duke shprehur fillimisht - nëse dikush shpërfill rregullat e përgjithshme të jetës - pikëpamjet e një shoqërie të caktuar, një grupi të caktuar shoqëror ose vetëm të një profesioni të vetëm.* (Beyer, A. & H. 1989, fq. 23). Fjalët e urta na përcjellin histori të vjetra, ngjarje, zakone, mençuri dhe imagjinata. Andaj këto u japin atyre një vlerë të veçantë në kontekstin ndërkulturor. Fjalët e urta që vijnë nga koha e mesjetës e bëjnë të qartë se thesari i fjalëve të urta të vjetra nuk buron nga një burim i vetëm. Ai thesar përbëhet nga shprehjet popullore vendore, nga thëniet dhe sentencat popullore letrare, nga fjalët e urta të huazuara që vijnë nga gjuhë të tjera.

Horst dhe Annelies Beyer janë të mendimit se shumë fjalë të urta, si për shembull: *Lügen haben kurze Beine* / (Gënjeshtra i ka këmbët e shkurtra), *Neue Besen kehren gut* / (Fshesat e reja fshijnë mirë) ose *der Krug geht so lange zum Wasser, bis er bricht* / (Shtamba mbushet me ujë, deri sa ajo të thyhet) (Beyer, A. & H. 1989, fq. 12), gati plotësisht korrespondojnë midis popujve evropianë dhe me sa duket janë shpërndarë nëpërmjet të migrimit të vazhdueshëm. Në vazhdim autorët vijnë në përfundime se kjo rezulton në dy gjëra: *E para, fjalët e urta, zakonisht kanë ngjashmëri ndërkombëtare dhe mund të transferohen dhe të integrohen lehtë, nëse ato kanë opinione të ngjashme. Së dyti, jo çdo përputhshmëri domosdo duhet parë si huazim: Rrethanat e ngjashme jetësore çojnë në përvoja dhe vlerësime të ngjashme, dhe antologjitë dhe imazhet e thjeshta janë pothuajse kudo të disponueshëm.* (po aty, fq. 12)

Një krahasim ndërkulturor i fjalëve të urta fillon me një qasje onomasiologjike, pikërisht ashtu si sugjeron Porsch për frazeologjizmat (Porsch, P. 1997, fq. 191). Në hulumtimin e tij Porsch vë në dukje se: *Aty mund të përdoren elemente leksikore të frazeologjizmave përkatëse, që si „shenjë kulturore“ i referohen një klasifikimi specifik të emërtimit.* (Porsch, P. 1997, fq. 191). Më tej thekson Porsch se duhen zbuluar: *Emërtimet e ndryshme që në bazë të interpretimit të ndryshëm kulturor mund të jenë si shenjë ekuivalente kulturore, respektivisht deri në çfarë mase për shembull ekziston përputhje në interpretimin kulturor të emërtimeve identike* (po aty, fq. 191). Është e rëndësishme që në një trajtim onomasiologjik duke përdorur emrat e kafshëve si elemente në fjalë të urta të trajtohen dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet gjuhës gjermane dhe asaj shqipe.

Pferd/Kalë (gjermanisht) [për fjalët e urta gjermanisht janë përdorur përkthime fjalë për fjalë]:

1. Aufs richtige Pferd setzen / (Vë bast në kalin e duhur)
2. Alles auf ein Pferd setzen / (Gjithçka vendos në një kalë)

3. Vom Pferd auf den Esel kommen /(Të kalosh nga kali në gomar!)
4. Das beste Pferd im Stall sein /(Të jesh kali më i mirë në stallë)
5. Arbeiten wie ein Pferd /(Të punosh si kalë)
6. Ein troianisches / trojanisches Pferd /(Kali i Trojës)
7. Ich glaub / denk, mich tritt ein Pferd! /(Unë besoj/mendoj se një kalë po më godet!)
8. Ein totes Pferd reiten /(Të kalërosh një kalë të ngordhur)
9. Ein gutes Pferd springt nicht höher, als es muss /(Një kalë i mirë nuk kërcen më lart se sa duhet)
10. Das Pferd am Schwanz von hinten aufzäumen /(Ta frenosh kalin nga bishti)
11. Auf jemanden einreden wie auf ein krankes Pferd /(Ta bindësh dikë si një kalë të sëmurë)
12. Aufs falsche Pferd setzen /(Të vësh bast në kalin e gabuar)
13. Wenn der Reiter nichts taugt, ist das Pferd schuld /(Kur kalorësi nuk është i mirë, fajin e ka kali). (Wörterbuch und Portal. Online më 10.11.2023).

Pferd/Kalë (shqip):

1. Kali i mirë s’do purtekë.
2. Kali i mirë e shton vetë tagjinë.
3. Kali i kuq e ka një huq.
4. Punon kali, ha gomari.
5. Kali i botës të le në mes të udhës.
6. Blihet kali, pastaj samari.
7. Kalit të falur s’i shihen dhëmbët.
8. Kali i mirë e shton vetë tagjinë.(Kadiu, K. Online më 12.11.2023).

Hund/Qen (gjermanisht) [për fjalët e urta gjermanisht janë përdorur përkthime fjalë për fjale]:

1. Ein linker Hund /(Një qen i majtë)
2. Ein scharfer Hund/(Një qen i mprehtë)
3. Ein falscher Hund /(Një qen i gabuar)
4. Wie Hund und Katze /(Si qeni dhe macja)
5. Ein blöder Hund /(Një qen budalla)
6. Wie ein Hund leben /(Si qen jeton)
7. Scheiß der Hund drauf! /(Dreq qen!)
8. Das ist ja ein dicker Hund! /(Ky është një qen i madh!)
9. Bekannt sein wie ein bunter Hund /(Të jesh i famshëm si një qen i larmishëm)
10. Jemanden wie einen Hund behandeln /(Të trajtosh dikë si një qen)
11. Dort liegt der Hund begraben /(Atje është qeni i varrosur)
2. Da wird (doch) der Hund in der Pfanne verrückt! (Qeni në tigan çmendet). (Wörterbuch und Portal. Online më 10.11.2023).

Hund/Qen (shqip):

1. Qenit tregoji shkopin
2. Qenit iu bëj qen
3. Qeni leh atje ku ha
4. Kujto (zër në gojë) qenin, rrëmbe (bëj gati) shkopin
5. Qeni që leh nuk të ha (nuk të kafshon)

6. Kush fle me qenin (me qentë), ngrihet me pleshta
7. Qentë le të lehin, karvani shkon përpara. (Spahiu, A. 2008, fq. 30).

Bär/Ari (gjermanisht) [për fjalët e urta gjermanisht janë përdorur përkthime fjalë për fjale]:

1. Bulle und Bär /(Demi dhe ariu)
2. Da ist der Bär los /(Andej është nisur ariu)
3. Wie ein Bär schlafen /(Fle si një ari)
4. Hungrig wie ein Bär sein /(Të jesh i uritur si ariu)
5. Da tanzt der Bär /(Aty vallëzon ariu)
6. Einen Schlag wie ein Bär haben /(Ta kesh një goditje si një ari)
7. Scheißt der Bär in den Wald? /(A e bën nevojën ariu në pyll?)
8. Das Fell verteilen, bevor der Bär erlegt ist /(Shpërndani leshin para se të vritet ariu). (Wörterbuch und Portal. Online më 10.11.2023).

Bär/Ari (shqip):

1. S'ngopet ariu me miza
2. Nuk trembet ariu (arusha) me shoshë. (Spahiu, A. 2008, fq. 1).

Porsch Peter është i mendimit se: *Në të gjitha gjuhët, cilësitë fizike të kafshëve dhe karakteristikat e tyre, qëndrimet ndaj tyre dhe përfitimet dhe vlera e tyre për njerëzit janë motiv kryesor për formimin e frazeologjizmave. Prandaj ka ngjashmëri (...) dhe dallime (...).* (Porsch, P. 1997, fq. 195). Këto qëndrime të Porsch-it mund të barten me sukses të fjalët e urta. Sepse në varësi të kuptimit teorik sipas Bußmann edhe fjalët e urta mund të përmbliken gjithashtu në frazeologjizma (Bußmann, H. 2008, fq. 530). Ngjashmëritë dhe dallimet e lartpërmendura formohen nga perceptimet kulturore përkatëse. Veçanërisht kafshët shtëpiake si kuajt ose qentë janë të rëndësishme si në kulturën gjermane po ashtu edhe në kulturën shqiptare dhe reflektohen me shumë karakteristika në fjalë të urta.

2. Fjalët e urta ekuivalente në gjermanisht dhe shqip

Për më tepër, bazuar në fjalët e urta në gjuhën gjermane një krahasim midis gjermanishtes dhe shqipes duhet të pasqyrojë edhe më qartë se identiteti dhe transformimi idiomatik janë si rrjedhojë e proceseve arbitrare të emërimit si dhe ngjashmërive dhe dallimeve kulturore. Në këtë studim do të vë në pah tre lloje kryesore të fjalëve të urta ekuivalente në gjermanisht dhe shqip:

a) Fjalë të urta që përshtaten si në formë ashtu edhe në përmbajtje, pra janë plotësisht identike.

Shembuj (për fjalët e urta gjermanisht janë përdorur përkthime të përshtatura në shqip):

1. Gjermanisht: Ein räudiges Schaf steckt die ganze Herde an.
Shqip: Delja e zgjebosur infekton gjithë kopenë.
2. Gjermanisht: Der Fisch fängt am Kopf an zu stinken.
Shqip: Peshkut qelbet nga koka.
3. Gjermanisht: Besser heute ein Ei als morgen die Henne.
Shqip: Më mirë një vezë sot se një pulë nesër.
4. Gjermanisht: Der Katzen Spiel ist der Mäuse Tod.

- Shqip: Loja e maces është vdekja e minjve.
 5. Gjermanisht: Ein gutes Pferd tragt ohne Peitsche.
 Shqip: Kali i mirë ecën pa kamxhik.
 6. Gjermanisht: Jede Krähe hält ihre Jungen für schön.
 Shqip: Çdo sorrë mendon se zogjtë e saj janë më të bukur.
 7. Gjermanisht: Mit den Wölfen muss man heulen.
 Shqip: Me ujqërit duhet të ulërish.
 8. Gjermanisht: Wo es Honig gibt, da sammeln sich die Fliegen.
 Shqip: Ku ka mjaltë aty mbledhen mizat.
 10. Gjermanisht: Auch eine schwarze Kuh gibt weiße Milch.
 Shqip: Edhe lopa e zezë jep qumësht të bardhë.
 11. Gjermanisht: Wer zwei Hasen zugleich jagt, fängt keinen.
 Shqip: Kush ndjek dy lepuj në të njëjtën kohë, nuk do të kapi asnjë.

b) Fjalët e urta që në aspektin semantike janë të ngjashme, por zëvendësohet një fjalë kyçe ose një përbërës tjetër. Në raste të tilla, fjalët e urta gjermane dhe shqipe janë mjaft të përafërta në përmbajtje.

Shembuj (për fjalët e urta gjermanisht janë përdorur përkthime të përshtatura në shqip):

1. Gjermanisht: Eine Schwalbe macht noch keinen Sommer.
 Shqip: Cicërima e dallëndyshes nuk e sjell pranverën.
2. Gjermanisht: Einem geschenkten Gaul sieht man nicht ins Maul.
 Shqip: Kalit të falur nuk i shikohen dhëmbët
3. Gjermanisht: Setz einen Frosch auf goldenen Stuhl, er springt doch wieder in den Pfuhl.
 Shqip: Edhe pse u vendos bretkosa mbi një qilim, ajo përsëri u hodh në ujë.
4. Gjermanisht: Wer vom Pferde gefallen ist, muss keinen Esel reiten.
 Shqip: Kush ka ra nga kali të mos ngjitet në gomar.
5. Gjermanisht: Die Schlange wechselt wohl die Haut, aber nicht die Giftzähne.
 Shqip: Gjarpëri nuk i tregon këmbët. (Agim, S. 2008, fq. 12).
6. Gjermanisht: Der Hund ist keck im eigenen Haus.
 Shqip: Qenit para derës së tij, nuk i besohet.
7. Gjermanisht: Die Arbeit ist kein Falke, fliegt nicht fort in den Wald.
 Shqip: Puna nuk është ujk, nuk shkon në pyll – ka thënë një dembel..
8. Gjermanisht: Besser ein Sperling in der Hand, als ein Kranich auf dem Dach.
 Shqip: Mos më premto një vinç në parajsë, por më jep një harabel në dorë.
9. Gjermanisht: Man muss den Pelz nicht verteilen, ehe der Bär geschossen ist.
 Shqip: Mos i premtoni një gruaje peliçen e ariut nëse akoma nuk e keni qëlluar.
10. Gjermanisht: Die Katze fällt immer wieder auf die Füße.
 Shqip: Macja nuk bie në shpinë.
11. Gjermanisht: Wo der Hund bellt, da mag er auch fressen.
 Shqip: Qeni aty ku ha, edhe leh.
12. Gjermanisht: Ein Schaf folgt dem andern.
 Shqip: Dhia ndjek dhinë, delja ndjek delen.
13. Gjermanisht: Alte Füchse gehen nicht in die Falle.
 Shqip: Një zog me përvojë nuk futet në rrjetë.

c) Fjalë të urta që ndryshojnë nga njëra-tjetra jo vetëm nga fjala kyçe ose nga komponentët e tjerë, por më tepër nga e gjithë përmbajtja leksikore, por edhe më tej konsiderohen ekuivalente.

Shembuj (për fjalët e urta gjermanisht janë përdorur përkthime të përshtatura në shqip):

1. Gjermanisht: Hunde, die viel bellen, beißen nicht
Shqip: Ai që flet shumë, nuk bën asgjë.
2. Gjermanisht: Hühner, die viel gackern, legen wenig Eier.
Shqip: Macja që fërshëllehet shumë nuk i kap minjtë.
3. Gjermanisht: Wo Knochen sind, da sind auch Hunde.
Shqip: Po të kishte mjaltë, mizat do të vinin nga Bagdadi.
4. Gjermanisht: Vögel, die morgens singen, holt am Abend die Katze.
Shqip: Nëse gjeli këndon në kohën e gabuar, atij i pritet koka.
5. Gjermanisht: Zwei Hähne vertragen sich nicht auf einem Misthaufen.
Shqip: Nuk mund t'i zieni dy koka desh në një tenxhere.
6. Gjermanisht: Das Kalb will oft klüger sein als die Kuh.
Shqip: Fëmija i tregon babait kufijtë e arës.
7. Gjermanisht: Das Ei will klüger sein als die Henne.
Shqip: Nipi i mësoi gjyshit historitë e vjetra.
8. Gjermanisht: Eine Krähe hackt der andern die Augen nicht aus.
Shqip: Një qen nuk shqyen leshin e tjetrit
9. Gjermanisht: Wenn die Katze aus dem Haus ist, dann tanzen die Mäuse.
Shqip: Kuajt ngordhën, vendi u ngeli gomarëve.
10. Gjermanisht: Wer den Gaul mietet, muss ihn auch füttern.
Shqip: Ai që ka vrarë qenin duhet ta tërheqë zvarrë.
11. Gjermanisht: Was der Löwe nicht kann, das kann der Fuchs.
Shqip: Më mirë dinakërinë se sa forcën
12. Gjermanisht: Getroffene Hunde bellen.
Shqip: Kush e ka mizën ndër kapuç
13. Gjermanisht: Alter Hund macht gute Jagd.
Shqip: Vetëm brirët e kaut të vjetër tërhiqen mirë.
14. Gjermanisht: Was kümmert's den Mond, wenn ihn die Hunde anbellern.
Shqip: Qeni leh, karvani ecën përpara.
15. Gjermanisht: Wenn man den Wolf nennt, so kommt er gerannt.
Shqip: Zë qenin në gojë, bëj shkopin gati.

Veçanërisht interesante për një krahasim ndërkulturor janë para së gjithash ekuivalentet e transformuara idiomatike të gjuhës shqipe me fjalët e urta në gjuhën gjermane. Në gjuhën shqipe disa transformime idiomatike zëvendësohen emërtimet e kafshëve, kurse përbërësit e tjerë ndryshojnë. Te disa transformime pa emërtime të kafshëve përdoren emërtime që vijnë nga mjedise jetësore rurale dhe fshatare ku janë pjesë e përditshmërisë si edhe gjetkë.

3. Përfundime

Si përfundim mund të thuhet se fjalët e urta shpesh ngërthejnë në vete një mençuri popullore, përvojë dhe rregull jetësor. Ato kanë karakteristika të rajonit dhe kohës së tyre. Fjalët e urta veprojnë edhe si ndërmjetës midis kohës së vjetër dhe të sotme. Ditë për ditë ne i përdorim fjalët e urta pa vetëdije dhe të panumërta, madje shpeshherë as që e dimë kuptimin dhe origjinën e tyre. Ato bazohen në histori, urtësi, citime, zakone dhe ide fetare. Kohët e vjetra gjallërojnë në fjalët e urta.

Prandaj në këtë punim janë përzgjedhur dhe përmenden arinjtë, qentë, kuajt, ujqit, lopët bretkosat, gjarpërinjtë etj. sepse këto kafshë dhe zvarranikë ishin edhe në të kaluarën e njerëzimit prezent. Veçanërisht kafshët shtëpiake si kuajt ose qentë janë të rëndësishme si në kulturën gjermane po ashtu edhe në kulturën shqiptare dhe reflektohen me shumë karakteristika në fjalë të urta. Kjo analizë krahasuese e fjalëve të urta të gjermanishtes dhe shqipes na mundëson që të vërtetojmë se cilat janë ndryshimet kryesore midis sistemeve të fjalëve të urta të të dyjave gjuhë. Gjithashtu ajo tregon qartë se si dhe në çfarë mënyre pasqyrohen këto dallime në strukturën semantike dhe formale të të dyjave gjuhëve.

Referencat

- [1]. Beyer, H./Beyer, A. (1989): Sprichwörterlexikon. Sprichwörter und sprichwörtliche Ausdrücke aus deutschen Sammlungen vom 16. Jahrhundert bis zur Gegenwart. Leipzig.
- [2]. Bünting, Karl-Dieter (1995): Redensarten, Sprichwörter, geflügelte Worte. Chur.
- [3]. Bußmann, Hadumod (2008). Lexikon der Sprachwissenschaft. Stuttgart.
- [4]. Kadri Kadiu: Shprehje popullore me figurën e kalit. <https://www.zemrashqiptare.net/news/43247/kadri-kadiu-shprehje-popullore-me-figuren-e-kalit.html>.
- [5]. Porsch, P. (1997). Phraseologismen im interkulturellen Vergleich. Në: Barz, I./ Schröder, M. (Hrsg.): Nominationsforschung im Deutschen. Festschrift für W. Fleischer zum 75. Geburtstag. Frankfurt/ Main, Berlin, Bern, New York, Paris, Wien.
- [6]. Spahiu, Agim (2008): Fjalët e urta në FGJSSH. Vrojtime leksikografike. https://shkenca.org/pdf/gjuhe/fjalet_e_urta.pdf.
- [7]. Redensarten-Index: https://www.redensarten-index.de/suche.php?suchbegriff=Pferd&bool=relevanz&gawoe=an&sp0=rart_ou&sp1=rart_varianten_ou.